




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS

Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 10.06.2025 DERI MË 13.06.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-6105-2025
2.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit.	NRP-02-6106-2025
3.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-6107-2025
4.	Vendim për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Rregullimi i shtratit të përroskës në fshatin Celinë"	NRP-02-6108-2025
5.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-6109-2025
6.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-6111-2025
7.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës "Ukshin Hoti"	NRP-02-6112-2025
8.	Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit komunal për ankesa në tatimin në pronë të paluajtshme.	NRP-02-6117-2025
9.	Vendim për shqyrtimin e kushteve urbanistike të lëndës së "Esra Palace".	NRP-02-6119-2025
10.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-6122-2025
11.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë	NRP-02-6123-2025




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “**Mirëmbajtja e hapësirave publike – lot 1**”, me nr. prokurimi: **623-25-3632-2-1-1** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-038-2-1-1**, të datës 9.6.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: “**Mirëmbajtja e hapësirave publike – lot 1**”, me nr. prokurimi: **623-25-3632-2-1-1** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-038-2-1-1**, të datës 9.6.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44, nën paragrafi 4.1 dhe 7 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 2 dhe 6, dhe neni 47, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1, të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr.Prot. 271 të datës 14.7.2014 për themelimin e komisionit komunal për riintegrim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. Hysen Hamza me nr. të letërnjoftimit 1500176250, i riatdhesuar nga Gjermania, i kthyer më datë 15.5.2025 me dhunë, i paraqitur në ZKKK më 19.5.2025, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim për 12 muaj, për herë të parë, nga data 2.6.2025 deri më 2.6.2026, në vlerën prej 280 euro për çdo muaj, duke i përfshirë edhe shpenzimet komunale, sipas kërkesës me nr. 1776, të datës 19.5.2025, të parashtruar në ZKKK, në Komunën e Rahovecit dhe sipas ofertës më të lirë.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është individ (1) - anëtarësh nga komuna e Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni komunal për riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 26.5.2025, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar më datë 19.5.2025, nga i riatdhesuari Hysen Hamza, nga komuna e Rahovecit, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira, ushqim dhe gjëra higjienike dhe medikamente, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. Hysen Hamza, po përballlet me një situatë të rëndë socio-ekonomike dhe është në kërkim të strehimit të përkohshëm, i cili bën pjesë si kategori e cënueshme dhe është deklaruar me sëmundje të ndryshme dhe diagnoza mjekësore (i ka bashkëngjitur në lëndën e tij dhe në kërkesë). Sipas Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, dhe neni 33, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe 6, komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe, sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari i plotëson kriteret për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira, të përcaktuara me Rregulloren QRK nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë në Komisionin për Ankesa në kuadër të Komunës së Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimiit.

Kopja e vendimit u dërgohet:

1. Të riatdhesuarit Hysen Hamza,
2. Koordinatorit Rajonal të MPB-së,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe
4. Arkivit të Komunës.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6107 Nr. i faq./Br.str/No.pg 113

Data/Datum/Date 10 / 6 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: **“Konkurs ndërkombëtar i projektimit për dizajnimin e logos së Komunës së Rahovecit – ritenderim”**, me nr. prokurimi: **623-25-2895-4-3-3** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-003-4-3-3**, të datës 10.6.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: **“Konkurs ndërkombëtar i projektimit për dizajnimin e logos së Komunës së Rahovecit – ritenderim”**, me nr. prokurimi: **623-25-2895-4-3-3** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-003-4-3-3**, të datës 10.6.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- **Anëtarëve të komisionit,**
- **Zyrës së Prokurimit, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6108 Nr. i faq./Br.str/No.pg 113

Data/Datum/Date 10 / 6 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot II – Rregullimi i shtratit të përroskës në fshatin Celinë", me numër të kontratës: 623-21-3119-5-1-1/C334, si në vijim:
 - 1.1. "P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

- brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
 - 4.4. Pas pranimi të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimi të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1238 i datës 25.11.2021.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Spektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, , nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Zyrës së Prokurimit të datës 9.6.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërhryrjet në raste emergjente infrastrukturore”, me numër të prokurimit: 623-25-3677-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-039-2-1-1, të datës 9.6.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërhryrjet në raste emergjente infrastrukturore”, me nr. prokurimi: 623-25-3677-2-1-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-25-039-2-1-1, të datës 9.6.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm nga hapja e ofertave.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6101 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114

Data/Datum/Date 11 / 06 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: **“Furnizimi me material higjienik – sanitar për shkollat e komunës së Rahovecit – ritenderim”**, me nr. prokurimi: **623-25-4730-1-2-1** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-015-1-2-1**, të datës 10.6.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Krasniqi, kryesues,
 - 1.2. Egzon Thaqi, anëtar,
 - 1.3. Anduena Dula, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: **“Furnizimi me material higjienik – sanitar për shkollat e komunës së Rahovecit – ritenderim”**, me nr. prokurimi: **623-25-4730-1-2-1** dhe me nr. të brendshëm: **623-25-015-1-2-1**, të datës 10.6.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Zyrës së Prokurimit, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENTIA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6112 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 11/06/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”), nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.05.2022, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për themelimin e çmimit “Ukshin Hoti” me 01 Nr. 292/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës “Ukshin Hoti”

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës “Ukshin Hoti”, në këtë përbërje:
 - 1.1. Besim Muhadri, kryesues,
 - 1.2. Fjolla Duraku, anëtare,
 - 1.3. Qemajl Krasniqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha propozimeve, si dhe përzgjedhjen e personalitetit për dhënien e dekoratës “Ukshin Hoti”, duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 e datës 31.5.2022 dhe në vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për themelimin e çmimit “Ukshin Hoti” me 01 Nr. 292/22 të datës 30.3.2022.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 16 qershor 2025, kur edhe do t’i rekomandojë kryetarit të Komunës personalitetin e viti për dhënien e dekoratës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / RAHOVEC MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6117 Nr. i faq./Br.str/No.pg 114

Data/Datum/Date 12 / 06 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 12 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 31 paragrafi 6 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-224, nenit 113 dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e Tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MF-NR. 02/2019 për Procedurat Ankimore të tatimit në Pronë, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit komunal për ankesa në tatimin në pronë të paluajtshme

1. Caktohen anëtarët e komisionit komunal për ankesa në tatimin në pronë të paluajtshme për Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fatmir Hoti, kryesues,
 - 1.2. Minire Hoti, anëtare,
 - 1.3. Shqipe Tara-Sokoli, anëtare.
2. Anëtarët e komisionit komunal për ankesa në tatimin në pronë të paluajtshme kanë për detyrë që të shqyrtojnë dhe të vendosin në lidhje me ankesat e qytetarëve për tatimin në pronë të paluajtshme të cilat i drejtohen këtij komisioni.
3. Mandati i komisionit është 1 (një) vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Obligohen anëtarët e komisionit që të veprojnë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ MF-NR. 02/2019 për Procedurat Ankimore të tatimit në Pronë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe anëtarët e komisionit komunal për ankesa në tatimin në pronë të paluajtshme.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendim u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shqyrtim të kushteve urbanistike të lëndës së “Esra Palace”, me
nr. 114 të datës 12.5.2025

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kushteve urbanistike të lëndës së “Esra Palace”, me nr.114, të datës 12.5.2025, në përbërje prej:
 - 1.1. Sylejman Daka - inxhinier ndërtimi, kryesues,
 - 1.2. Gëzim Zeka - inspektor i ndërtimit, anëtar,
 - 1.3. Fiknete Kasapi – Iska - zyrtare ligjore, anëtare,
 - 1.4. Fatmir Kryeziu - ekspert nga jashtë, anëtar,
 - 1.5. Valon Canziba - ekspert nga jashtë, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e kushteve urbanistike të lëndës së “Esra Palace”, me nr.114, të datës 12.5.2025 dhe t’i rekomandojë organit kompetent për mënyrën e vendosjes.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat prej 15 ditësh, duke filluar nga 13.6.2025 deri më 28.6.2025.
5. Obligohet komisioni që pas përfundimit të shqyrtimit të kushteve urbanistike të “Esra Palace”, me nr.114, të datës 12.5.2025, ta njoftojë kryetarin e Komunës dhe drejtorin për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për mënyrën e vendosjes.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Urbanizëm , Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
- Arkivit.



Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022 të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit të datës 5.6.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C615, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me nr. Identifikues: 623-24-7267-2-1-1/C615, me nr. prot. 1993, e datës 5.6.2025.
2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Veton Kabashi nga Rahoveci ka parashtruar kërkesë të menaxheri i kontratës me nr. prot. 1772, të datës 19.5.2025, për shkëputjen e kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues: 623-24-7267-2-1-1/C615, i cili ishte i angazhuar konsulent individual për vlerësimin e pronave komunale në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa nga data 24.9.2024.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me kërkesën e datës 5.6.2025, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ ndërprerjen e kontratës me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues: 623-24-7267-2-1-1/C615 dhe me nr. prot. 3046, e datës 24.9.2024, në të cilën Veton Kabashi ishte i angazhuar konsulent individual për vlerësimin e pronave komunale në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues: 623-24-7267-2-1-1/C615, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të ofruesit të shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës së datës 24.9.2024, me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues: 623-24-7267-2-1-1/C615.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- ***Veton Kabashi,***
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe vijushmërinë e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Ardit Berisha me Nr. Prot. 2026 të datës 12.06.2025, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë Ardit Berisha nga Drenoci, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Mjek Stomatolog në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” ne Rahovec, në Komunën e Rahovecit, nga data 14.06.2025 deri me date 14.06.2026.
2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet Zyrтари/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largoj nga lista e pagës zyrtarin e lartpërmendur për periudhën e lartcekur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ardit Berisha nga Drenoci, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Mjek Stomatolog në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” ne Rahovec, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 2026 të datës 12.06.2025, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej datës 14.06.2025 deri me date 14.06.2026.

Kërkesën i lartpërmenduri e ka parashtruar për arsye të ngritjes profesionale, respektivisht kryerjen e specializimit.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe vijushmërinë e Zyrtarëve Publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrтари publik ta shfrytëzoj pushimin pa pagesë, për përkujdesjen e shëndetit të vajzës së tij.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Ardit Berisha nga Drenoci,*
- *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrtari/ja për paga,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

